

## Biografi – Lirika Pula, pianiste

E lindur në Gjakovë, Lirika Pula mesimet e shkolles se mesme i vijoi ne Prishtine ne klasen e pedagogut Agron Shujaku. Ne keto vite u paraqit ne koncerte te vazhdueshme ne Prishtine dhe qytete tjera te Kosoves.

Repertori pianistik i saj përfshinë vepra të stileve dhe kompozitorëve të ndryshëm, që nga baroku e deri te impresionizmi Ravelian, vepra këto që kërkojnë aftësi të konsiderueshme teknike dhe interpretative. Këto vepra i luajti kryesisht gjatë kohës së studimeve pranë Akademisë së Arteve të Bukura në Tiranë. Ajo i përfundoi studimet me sukses të plotë në vitin 2006, në klasën e pedagoges dhe pianistes së shumërespektuar Merita Rexha Tershana. Poashtu, ishte pjesëmarrëse e rregullt e masterklasëve nga pianistë të ndryshëm, si dëgjuese dhe performuese.

Gjatë kësaj periudhe luajti në disa festivale si soliste: DAM fest (2006, Prishtinë), Festival i Chopenit (2006, Tiranë), e poashtu në formacion muzikë dhome. Ka koncertuar me instrumentiste te ndryshem, shqiptare dhe jo vetem. Me klarinetistin Rasmus Krøyer nga Danimarka u paraqit ne DAM fest 2012 ne Prishtine dhe Gjakove.

Qe nga vitit 2006, Lirika është angazhuar si pedagoge e pianos ne shkollën e muzikës ‘Prenk Jakova’ në Prishtinë. Ndersa aktualisht punon edhe si pianiste ne katedren e Kantos prane Fakultetit te Muzikes ne Prishtine.

Në tetor të vitit 2011 ajo mbrojti diplomën Master në klasën e Profesor Todor Svetiev, në Shkup ( Universiteti “ Kiril dhe Metodij”) performancë kjo e vlerësuar me rezultatet maksimale.

Ne Gusht te vitit 2013 ishte pjesemarrrese kursit veror ” Accademia Chigiana” ne Siena te Italise, ku mbajti mesime me pianisten e njohur ruse LILYA ZILBERSTEIN.

Ne janar te ketij viti mori pjese ne festivalin pianistik te mbajtur ne Tirane ‘Pianodrom”, ne nje mbremje dedikuar veprave nga autore kosovare.